



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL OF ASSEMBLY- SUHAREKA
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores MF – Nr. 02/2013 – për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Llaptopat që i ka blerë Komuna anëtarëve të Kuvendit të Komunës në Suharekë, Ju dhurohen dhe të njëjtit nuk kthehen dhe nuk regjistrohen në regjistrin e pasurisë së Komunës.

Neni 2

Dhurimi i llaptopëve për anëtarët e Kuvendit të Komunës, bëhet me qëllim, që të ju krijohen kushte sa më efikase, efektive dhe uljen e shpenzimeve të administratës së Komunës që tani e tutje anëtarëve të Kuvendit të Komunës të mos ju dërgohet ftesa dhe materiali për mbledhje në kopje fizike, në reduktimin e përdorimit të letrës, rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit në mesë anëtarëve të Kuvendit të Komunës dhe zyrtareve të tjerë për mesë shkëmbimit të emailave, video-konferencave dhe mjeteve tjera digjitale për të diskutuar çështje dhe për të koordinuar veprimet, përmirësimin e transparencës me qëllim që të kenë akses më të lehtë dhe më të shpejt në informacione publike dhe të monitorojnë aktivitetet e administratës së Komunës si dhe përshtatjen me teknologji moderne.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtorin për ekonomi, financa dhe buxhet të Komunës së Suharekës.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Me datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI